Një tjetër hap konkret në rrugën drejt integritetit akademik.

Universiteti “Eqrem Çabej” mori pjesë në takimin e VIII online në kuadër të projektit SINCERE (Erasmus+ CBHE), duke shënuar përmbylljen me sukses të fazës së parë 6-mujore.

Takimi, i drejtuar nga Universiteti “Fan S. Noli”, bëri bashkë partnerë nga Ballkani Perëndimor, Polonia dhe Serbia, në një diskutim të përbashkët mbi rezultatet e arritura dhe hapat e radhës.

UGJ u përfaqësua nga Task Forca për Integritetin Akademik të projektit SINCERE për UGJ-në.

Gjatë takimit u analizuan produktet e zhvilluara në këtë fazë, përfshirë:

Udhëzuesin e Vlerësimit të Riskut, Planin e Cilësisë dhe Planin e Diseminimit, të cilat u miratuan nga partnerët përpara ngarkimit në platformën SyGMa.

Të gjitha u miratuan nga partnerët, duke konfirmuar progresin e arritur dhe gatishmërinë për fazën e ardhshme.

Projekti vijon me aktivitete të reja, bashkëpunim ndërinstitucional dhe angazhim të qëndrueshëm për forcimin e kulturës së integritetit në arsimin e lartë.






# *Çfarë u arrit?*

- Udhëzuesi i Riskut
- Plani i Cilësisë
- Plani i Diseminimit
- Miratuar nga partnerët





# *Faza e parë u përmbyll me sukses*

Projekti vijon me aktivitetet e ardhshme